

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
AGJENCIONI KOSOVAR PËR PRONA, KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
KOSOVSKA AGENCIJA ZA IMOVINU, ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-205/15

**Prishtinë,
7 shkurt 2018**

Në çështjen ligjore të:

B. M.,

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar i trupit gjykues, Krassimir Mazgalov dhe Isa Kelmendi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/244/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA44813), të datës 18 Qershor 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 7 Shkurt 2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga B. M. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/244/2014, të datës 18 Qershor 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA44813, refuzohet si e pabazuar
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/244/2014, i datës 18 Qershor 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar me numrin KPA44813.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 20 Gusht 2007, Ž. M. (në tekstin e mëtutjeshëm: paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtutjeshëm: AKP) ku kërkonte ririposimin e ngastrës kadastrale nr. ... me sipërfaqe prej 0.50.34 ha, që ndodhej në vendin e quajtur *emri i vendit ...*, Komuna e Lipjanit (në tekstin e mëtutjeshëm: prona e kërkuar), për të cilën pohonte se ishte pronar dhe se e kishte humbur posedimin si pasojë e rrethanave që lidhen me konfliktin e armatosur kurse tani prona ishte e uzurpuar.
2. Së bashku me kërkesën ai kishte dorëzuar në AKP *inter alia* dokumentet vijuese:
 - Aktvendimin Trashëgimie O.br.134/84 të lëshuar me datën 28 Janar 1985 nga Gjykata Komunale e Lipjanit me të cilin paraqitësi i kërkesës shpallet trashëgimtar i pronës së kërkuar,
 - Certifikatë vdekje lëshuar nga Komuna paralele e Lipjanit me 5 janar 2007 që dëshmon se babai i paraqitësit të kërkesës J. M. ka ndërruar jetë me 1 Shtator 1969,
 - Kopje e listës poseduese 339 lëshuar nga zyra kadastrale 22 shkurt 2008 e Lipjanit me 22 shkurt 2008 e ku dëshmohet se ngastra kadastrale *numri i parcelës ...* me sipërfaqe 0.50.34 ha është në emër të paraqitësit të kërkesës.
 - Kopje e listës poseduese 339 lëshuar nga zyra kadastrale e UNMIK-ut në Lipjan me 15 Mars 2007 e ku dëshmohet se ngastra kadastrale *numri ...* me sipërfaqe 0.50.34 ha është në emër të paraqitësit të kërkesës.
 - Dëshmi e lëshuar nga zyra kadastrale e Lipjanit e dislokuar në Serbi me 8 Shkurt 2007 me të cilën vërtetohet se në pika 2 e Aktvendimit Trashëgimior O.br.134/84 i datës 28 Janar 1985 përmirësohet si ne vijim: ngastra kadastrale ... gjendet ne vendin e quajtur *emri i vendit...* dhe është arë me sipërfaqe prej 0.12.46 ha ndërsa ngastra kadastrale ... gjendet ne vendin e quajtur *emri i vendit ...* dhe është arë me sipërfaqe prej 0.50.34 ha.
3. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së identifikuar pronën me 9 mars 2010 dhe kishte gjetur se prona e kërkuar nuk ishte e uzurpuar.

4. Pasi që asnjë palë nuk kishte paraqitur përgjigje në kërkesë brenda afatit ligjor prej 30 ditëve, në pajtim me nenin 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079, kërkesa u konsiderua si e pa-kontestuar.
5. Sipas raporteve të Verifikimit të 24 dhjetor 2009 prona e kërkuar ishte e evidentuar në emër të S. M.
6. Parashtruesi ishte kontaktuar disa herë me telefon nga zyrtarët e AKP-së dhe ishte kërkuar të sillte dokumenta shitesë sepse sipas evidencës prona e kërkuar ishte gjetur në emër të vëllait të tij S. (shih shkresat e lëndës faqe 52-55).
7. Më 30 Prill 2014, KKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/A/244/2014 (në tekstin e mëtejshëm: “Vendimi i KKPK-së”, “Vendimi”) e kishte hedhur poshtë kërkesën për shkak të faktit se ajo binte jashtë juridiksionit të Komisionit pasi që posedimi i pronës së kërkuar nuk ishte humbur si rezultat i konfliktit të armatosur që kishte ndodhur në Kosovë gjatë viteve 1998-1999.
8. Ž. M. kishte vdekur me 4 Janar 2012 në Beograd. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar bashkëshortës të paraqitësit të kërkesës B. M., (më tutje: pala ankuese) më 7 Nëntor 2014. Ajo kishte paraqitur ankesë më 4 Dhjetor 2014.

Pretendimet e palës ankuese

9. Pala ankuese thekson se Vendimi i KKPK-së është nxjerr në shkelje të dispozitave procedurale dhe me gabime lidhur me gjendjen faktike si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale. Ajo thekson më tej se Vendimi është marrë duke aluduar se humbja e pronës nuk lidhet me konfliktin apo rrethanat që ndërlikohen me të nuk është i vërtetë. Komisioni sipas palës ankuese nuk i ka kryer të gjitha veprimet procedurale dhe shqyrtimin e fakteve dhe provave për të ardhur në konkludim korrekt lidhur me kërkesën. Ky vendim është marrë pa shqyrtim të provave në themel.
10. Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që të prish Vendimin e KKPK-së dhe të bie aktgjykim me të cilin ia njeh palës ankuese të drjtën e pronësisë dhe i kthen posedimin mbi pronën.

Arsyetimi ligjor

11. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palës ankuese, në pajtim me nenin 12 dhe 13 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe nenin 194 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, Gjykata gjeti se Ankesa është e pranueshme. Kjo për arsye se është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditësh sikurse parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.
12. Paraqitësja e ankesës ka dëshmuar se është anëtarë i ngushtë i familjes së paraqitësit të kërkesës komfor dispozitës së nenit 1 paragraf.12 të Urdhërësës Administrative nr. 2007/5

për implementimin e Rregullores të UNMIK-ut nr. 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronat bujqësore dhe ato komerciale, ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 që ka të bëjë me përkufizimin si “Anëtar i familjes” nënkupton *bashkëshorti apo bashkëshortja, fëmijët (e lindur në martesë apo të birësuar) dhe personat e tjerë, të cilët është i obliguar t’i përkerabë poseduesi i të drejtës në pronë në përputhje me ligjin në fuqi, apo personat që janë të obliguar ta përkerabin poseduesin e të drejtës në pronë në përputhje me ligjin në fuqi,*”

13. Gjykata Supreme, pasi që kishte shqyrtuar pretendimet në ankesë dhe përmbajtjen e dosjes së lëndës, konstaton se Vendimi KKPK-së nuk përfshinë asnjë gabim thelbësor apo zbatim të gabuar të së drejtës së aplikueshme materiale dhe as nuk mbështetet në vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të fakteve. Prandaj, ankesa nuk mund të miratohet.
14. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë të zgjidh kërkesat pronësore që kanë të bëjnë me konfliktin dhe kërkesat për të drejtën pronësore “që drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 apo që rezultojnë nga ai. Bazuar në dokumentat e parashtruara dhe të gjetura në regjistrat përkatës prona ishte e evidentuar në emër të S. M. dhe me sipërfaqe te ndryshme nga ajo e kërkuara.
15. Gjatë pranimit të kërkesës pala ankuese ka treguar se burri i saj i ndjerë është pronar legjitim por prona është e uzurpuar ilegalisht nga kunati i saj për arsye se Aktvendimi i Trashëgimisë nuk ishte ekzekutuar.
16. Gjykata Supreme, pas shqyrtimit të provave të mbledhura në këtë lëndë, vlerëson se pala ankuese nuk ka dëshmuar se humbja e posedimit të pronave të kërkuara ka të bëjë me konfliktin. Në anën tjetër, sipas Raportit të Verifikimit prona e kërkuar është në emër të S. M., dhe se kontesti përqendrohet në çështjen e vendimit të trashëgimisë të vitit 1984.
17. Kjo bën që Gjykata Supreme të arrijë në përfundim se KKPK-ja ka marrë vendim të drejtë për arsye të drejta kur ka hedhur poshtë kërkesën e palës ankuese. Komisioni ka të drejtë kur ka konsideruar se pala ankuese nuk ka arritur të dëshmojë humbjen e të drejtës pronësore mbi atë pronë menjëherë para ose gjatë konfliktit të vitit 1998/99.
18. Për sa i përket pretendimeve të palës ankuese se vendimi për kërkesën ishte marrë pa prezencën e saj dhe kërkesës që Komisioni është dashur të hape shqyrtim dhe të therras palën ankuese, Gjykata Supreme ve në pah si në vijim: Neni 5.3 i Shtojcës III të Urdhëresës Administrative 2007/5 për Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën e Paluajtshme Private përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale thekson se: “*Procedura para Komisionit bazohet në parashtrësata verbale dhe dokumentat, aty ku e kërkon interesi i drejtësisë, seanca verbale. Në kuptim të nenit 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, për kërkesat vendoset mbi bazën e parashtrësave nga palët, përfshirë provat dokumentuese*”. Gjithashtu, Gjykata Supreme është e mendimit se lënda aktuale nuk ka nevojë për sqarime shtesë dhe prandaj nuk është e nevojshme të zbatohet neni 12.10 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079 dhe të mbajë shqyrtim.

19. Duke marr parasysh atë që u tha më lartë, në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.
20. Ky aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e palës ankuese për të kërkuar të drejtat e tij para gjykatës kompetente, nëse ai e sheh këtë të domosdoshme.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme.

Beshir Islami , kryetar i kolegjit

Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it

Isa Kelmendi, gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam, referent i EULEX-it